



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

Durrës – Sekuestrohen 600 fishekzjarrë dhe mallra të kontrabanduara. Procedohen penalisht 5 shtetas

Tiranë – Goditet një tjetër rast i mitëdhënies

Tiranë/Vihen në pranga 6 shtetas, për vepra të ndryshme penale

DVP Elbasan/Vihen në pranga 3 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 5 shtetas dhe vijon puna për kapjen 1 tjetri, për vepra të ndryshme penale

Klos/Evidentohet dhe goditet një tjetër rast i organizimit të kundërligjshëm të lojërave të fatit

Lajmet

27/12/2023

Kurbin/Policia Parandalon Një Ngjarje Të Rëndë Kriminale

Kurbin/Policia parandalon një ngjarje të rëndë kriminale.

Mori armën e zjarrit në banesë, dhe qëlloi në drejtim të banesës së një 60-vjeçari, për shkak të një konflikti të çastit, duke iu rrezikuar seriozisht jetën familjarëve, kur pa që po mbërrinte Policia, u largua në pyll.

Pas kërkimeve dhe ndjekjes intensive, të kryera gjatë natës, në territorin e fshatit Malbardhë, nga Policia e Kurbinut, Forcat Operacionale dhe Shqiponjat e DVP Lezhë, Forcat e Sigurisë Kombëtare dhe forcat speciale “RENEA” u bë e mundur kapja dhe vënia në pranga e 41-vjeçarit që qëlloi me armë zjarri, drejt banesës së 60-vjeçarit.

Gjithashtu në këtë zonë shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan armën e zjarrit pushkë me të cilën qëlloi i arrestuari.

Në kuadër të punës intensive dhe të pandërprerë të Policisë, në të gjithë territorin e qarkut, me objektiva kryesorë, parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe garantimin e sundimit të ligjit në territor, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, në bashkëpunim me Forcat e Sigurisë Kombëtare dhe me shërbimet e Repartit “RENEA”, falë reagimit në kohë, kanë bërë të mundur parandalimin e përshkallëzimit të një konflikti me pasoja të rënda.

Shtetasi R. M., rreth mesnatës, është konfliktuar për motive të dobëta, në ambientet e një lokali, me shtetasin C. H., 60 vjeç. Më pas ky shtetas ka marrë armën e zjarrit, në banesën e tij, ka qëlluar me të, në drejtim të banesës së 60-vjeçarit, me pasojë vetëm dëme materiale, dhe është larguar në zonën e pyllëzuar të fshatit Malbardhë, Kurbin, për t’u fshehur.

Si rezultat i kërkimeve dhe ndjekjes së kryer gjatë natës, pa ndërprerje, në territorin e fshatit Malbardhë, shërbimet e Policisë kapën dhe vunë në pranga shtetasin R. M., 41 vjeç, banues në këtë fshat. Gjithashtu, gjetën në këtë zonë dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, armën e zjarrit pushkë, me të cilën qëlloi 41-vjeçari.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit te Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Raporti i ngjarjeve, 24,25,26 dhjetor 2023

Klos/Evidentohet dhe goditet një tjetër rast i organizimit të kundërligjshëm të lojërave të fatit ▶